



## Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri

Përmbledhja e Raportit 2013 dhe  
2014

Dhjetor 2015

**Deloitte.**

**Adresa:**

EITI Shqipëri

Extractive Industries Transparency Initiative

Tel: +355 422 64 645

Faqja e internetit: [www.albeiti.org](http://www.albeiti.org)

E-mail: [sekretariati@albeiti.gov.al](mailto:sekretariati@albeiti.gov.al)

Blv. "Zhan Dark", Godina nr. 3 (ish ME), kati 4,  
Tirana, Albania

# Përmbajtja

Çfarë është EITI?	5
Industria nxjerrëse në Shqipëri	6
Sektori i hidro-energjisë në Shqipëri	11
Kontributi në ekonominë shqiptare	14
Rakordimi i të ardhurave dhe pagesave	19





Burimet natyrore i përkasin qytetarëve të një vendi. Qytetarët kanë të drejtë të informohen për mënyrën se si po i administron Shteti këto burime. Megjithatë, në shumë vende ky informacion nuk është publik.

EITI bazohet në besimin se përdorimi i matur i burimeve natyrore sjell rritje ekonomike, zhvillim të qëndrueshëm dhe reduktim të varfërisë në vendet e pasura me burime natyrore.

# Çfarë është EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (“NTIN” ose EITI”) është një koalicion vullnetar ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, të tilla si nafta, gazi dhe minerale të tjera. Nisma rregullohet nëpërmjet një standarti ndërkombëtar, “Standarti EITI”.

EITI ka për qëllim promovimin e transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t’i sigurojë qytetarëve një bazë për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave

Kjo nisëm fillon një proces ku Shteti do të jap llogari para qytetarëve për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Standartit EITI kërkon që shoqëritë të publikojnë atë që paguajnë dhe shtetet të publikojnë atë që arketojnë. Këto pagesa do të rakordohen nga një administrator i pavarur dhe do të paraqiten në raportin vjetor të EITI-t. Përkrah pagesave, ky raport do të paraqes informacion gjithëpërfshirës për shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe kontributin në ekonomi.

## EITI në Shqipëri

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri u themelua në vitin 2009. Shqipëria u bashkua si kandidate e EITI në maj 2009 dhe fitoi statusin e plotë të anëtarësisë në maj 2013.

Proçesi në Shqipëri mbikqyret nga Grupi Ndërinstitucional i Punës (“MSG” ose “Grupi Shqiptar i Punës”) i përbërë nga disa grupe interesi të EITI-t duke

përfshirë Qeverinë, shoqëritë nxjerrëse, shoqërinë civile etj.

Grupi Shqiptar i Punës, i cili është organi vendimmarrës dhe mbikqyrësi i zbatimit të EITI-t në Shqipëri, drejtohet nga zv. Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Sekretariati i EITI-t në Shqipëri (“AlBEITI”) mbështet Grupin Shqiptar të Punës në përmbushjen e detyrave të tij..

Në kuadrin e zbatimit të kësaj nisme, më 14 korrik 2015, Grupi Shqiptar i Punës caktoi Deloitte si administrator të pavarur të raportit EITI në Shqipëri për vitet 2013 dhe 2014.

MSG vendosi që përkrah sektorit të naftës, gazit dhe atij mineral të përfshijë në raportin EITI për vitet 2013 dhe 2014, sektorin e hidro-energjisë.

EITI Shqipëri ka publikuar pesë raporte përkatësisht, për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

Ky publikim paraqet një përmbledhje të raportit të pestë, që mbulon përkatësisht vitet 2013 dhe 2014.

Për më shumë informacion rreth kuadrit ligjor, aktivitetit të industrisë, të ardhurave që mbledh Shteti dhe procesit të raportimit referojuni raportit të plotë.

Më shumë informacion rreth EITI në Shqipëri dhe raportet EITI do të gjeni në Zyrën e AlBEITI në adresën Blv. “Zhan D’Ark”, Godina nr. 3 (ish ME), kati 4, Tiranë ose në faqen e internetit [www.albeiti.org](http://www.albeiti.org).

# Industria nxjerrëse në Shqipëri

Industria nxjerrëse në Shqipëri rregullohet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë ("MEI"), e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave publike në sektorin e energjisë dhe burimeve natyrore dhe për monitorimin e zbatimit të legjislationit.

MEI është përgjegjëse për dhënien e licënsave të kërkimit dhe shfrytëzimit (prodhimit) në sektorin e naftës, gazit dhe minierave. Më shumë informacion rreth planit të zhvillimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe procedurave të licënsimit do të gjeni në faqen e internetit të Ministrisë: [www.energjia.gov.al](http://www.energjia.gov.al).

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ("AKBN") dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ("SHGJSH") mbështesin MEI-n në procedurat para dhe pas licënsimit, përkatësisht AKBN për licënsat e prodhimit dhe SHGJSH për licënsat e kërkimit. Procedurat para-licënsimit përfshijnë: promovimin e zonave të pashfrytëzuara, udhëzimin e operatorëve potencial mbi procesin, verifikimin teknik të planit të propozuar të prodhimit dhe negocimin e planit të investimeve dhe kushteve të tjera. Procedurat e pas-licënsimit përfshijnë monitorimin e aktivitetit të të licënsuarve përmes raportimeve periodike nga të licënsuarit dhe monitorimin në terren.

Albpetrol Sh. A. është Shoqëria e vetme e zotëruar nga Qeveria Shqiptare që vepron në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e naftës bruto dhe e gazit. Me anë të ligjit nr. 10490, datë 15 dhjetor 2011, Kuvendi i Shqipërisë vendosi për privatizimin e Albpetrol.

Një vështrim i përgjithshëm i situatës aktuale të licënsimit dhe zonat e lira për licënsim në kërkim dhe prodhim paraqitet përkatësisht në faqen e internetit të AKBN: [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al) dhe në faqen e Albpetrol [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al) për licënsat e administruara prej tij.



## Kërkimi, zhvillimi, dhe prodhimi i naftës dhe gazit

Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i naftës dhe gazit në Shqipëri rregullohen nga Ligji nr. 7746 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)" datë 28 korrik 1993 ("Ligji i hidrokarbureve").

Ligjin për hidrokarburet përcakton shprehimisht se të gjitha depozitat e naftës që ndodhen në gjendjen e tyre natyrore në shtresat tokësore brenda juridiksionit të Shqipërisë, janë pronë ekskluzive e Shtetit shqiptar.

Bazuar në këtë ligji Ministria e Energjisë dhe Industrisë mund të nënshkruajë Marrëveshje Hidrokarbure, të cilat i japin shoqërisë së naftës të drejta ekskluzive për të kërkuar dhe prodhuar naftë dhe gaz për një periudhë fillestare prodhimi jo më shumë se 25 vjet. Ky afat mund të zgjatet në përputhje me ligjin për hidrokarburet.


Të gjitha marrëveshjet hidrokarbure janë hartuar si Marrëveshje me Ndarje të Prodhimit ("MNP" ose "PSA"), të nënshkruara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) si përfaqësuese e Qeverisë Shqiptare. Albpetrol, është palë në këto marrëveshje kur ato i referohen të drejtave dhe zonave për kërkim-prodhim nën administrimin e tij.

## Rezervat e naftës dhe gazit <sup>1</sup>

Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918. Që nga ajo kohë, u zbluluan fusha naftë-mbajtëse në 11 zona tokësore.

Vendburimet e naftës në Shqipëri shtrihen në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore të vendit, dhe janë kryesisht në dy struktura: vendburime ranore dhe vendburime gëlqerore. Aktualisht këto vendburime kanë rezerva të konsiderueshme por shfrytëzimi i plotë i tyre kërkon metoda të avancuara dytësore për nxjerrjen e naftës.

Bazuar në studimet e kryera nga shoqëritë e huaja dhe Albpetrol në vitet 1985-1990, rezervat e naftës në vendburimet e zbuluara në Shqipëri arrinin në rreth 437.6 milion ton, megjithatë rezervat e rekupeueshme sipas vlerësimeve të atëherëshme nuk i kalonin 81 milion ton.



Rezervat në vendburimet e zbuluara të gazit natyror në Shqipëri përllogariten në 18,164 milion Nm<sup>3</sup><sup>1</sup> dhe shtrihen kryesisht në zonën e Kuçovës dhe Patosit. Sasia kumulative e gazit të prodhuar deri në fund të vitit 2012 ishte 12,504 milion Nm<sup>3</sup>.

Figura 1 - Fushat e naftës dhe gazit në Shqipëri

Tabela më poshtë paraqet vlerësimet e rezervave gjeologjike dhe të rekupeueshme në fushat ekzistuese të naftës në milion ton:

Tabela 1 - Rezervat gjeologjike dhe të rekupeueshme të naftës në milion ton<sup>1</sup>

Fushat naftë-mbajtëse	Rezervat në milion ton		Prodhimi kumulativ deri në 2014
	Gjeologjike	Rekupeuar	
Cakran –Mollaj	16.1	8.1	4.3
Ballsh-Hekal	19.3	6.4	5.1
Gorisht –Kocul	30.5	14.7	12.0
Amonice	0.4	0.1	0.1
Visokë	2.8	1.5	0.7
Delvine	28.4	6.8	6.2
Finiq –Krane	0.3	0.1	0.0
Drashovica	1.0	0.2	0.0
<b>Total shkëmbinj gëlqeror</b>	<b>98.9</b>	<b>37.9</b>	<b>28.4</b>
Marineza	258.4	31.1	25.4
Kucova	78.3	11.8	4.3
Rase-Pekisht	2.0	0.2	0.0
<b>Total shkëmbinj ranor</b>	<b>338.7</b>	<b>43.1</b>	<b>29.7</b>
<b>Totali</b>	<b>437.6</b>	<b>81.0</b>	<b>58.1</b>

Rezervat gjeologjike të vlerësuara në strukturat ranore përbënin 77.4% të rezervave totale, megjithatë rikuperimi i tyre është vlerësuar në masën 13%. Rikuperimi i rezervave gjeologjike nga strukturat gëlqerore varion nga 24% në 53%. Albpetrol raporton se prodhimi kumulativ i naftës bruto nga strukturat ranore dhe gëlqerore deri në 31 dhjetor 2014 përllogaritet në 58 milion ton.

1 - Informacioni për rezervat dhe prodhimin kumulativ është raportuar nga Albpetrol. Të dhëna të përmblëdhura janë paraqitur në këtë adresë: <http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/>

# Industria nxjerrëse në Shqipëri

Në vitin 2013, AKBN raportoi prodhim të naftës bruto prej 1,203,637 ton vlerësuar në 530 milion USD. Prodhimi në vitin 2014 u rrit në 1,386,124 ton dhe u vlerësua në 549 milion USD.

## Prodhimi i naftës dhe gazit

Prodhimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1929, me 750 ton naftë bruto në vit. Pas Luftës së Dytë Botërore prodhimit u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe arriti pikun në vitin 1974 me një prodhim prej 2.25 milion ton në vit. Në vitet '80 prodhimi i naftës ra nën 1 milion ton në vit dhe arriti përsëri në mbi 1 milion ton në vitin 2012.


Në vitin 2013 dhe 2014 sektori i naftës dhe gazit numëronte pesë shoqëri që prodhonin naftë dhe gaz në pjesën jugore të Shqipërisë dhe gjashtë shoqëri të angazhuara në kërkim-zbulim.

Nafta e prodhuar nga të licënsuarit private që operojnë në sektorin e hidrokarburave përfaqëson rreth 97% të totalit të naftës së prodhuar në vitin 2013 dhe 2014. Rreth 88% e prodhimit vendas të naftës në 2013 dhe 87% në 2014 u gjeneruar nga Bankers Petroleum që operon fushën e naftës në Patos-Marinzës.


Albpetrol<sup>2</sup> raportoi se në vitin 2013 dhe 2014 u nxorrën respektivisht rreth 22.5 milion Nm<sup>3</sup> dhe 17.7 milionë Nm<sup>3</sup> gaz përmes prodhimit të naftës.

Panëvarësisht rritjes në prodhimin e naftës, numri i punonjësve në sektor u zvogëlua me 23% gjatë katër viteve të fundit. Këto ndryshime rrodhën si pasojë e transferimit të operacioneve të prodhimit nga Albpetrol tek shoqëritë private të naftës në përputhje me PSA-të në fuqi. Siç vihet re, sektori privat, nuk arriti të përthithë fuqinë punëtore të larguar nga puna gjatë këtyre transferimeve. Në vitin 2014 sektori i kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve punësoi rreth 3,109 punonjës, duke kontribuar në punësimin vendas me rreth 0.3% të fuqisë punëtore të regjistruar sipas INSTAT. Albpetrol ishte punëdhënësi më i madh në sektor me rreth 2,062 punonjës ose 66% të punësimit në sektor.

Grafiku 1- Nafta e prodhuar në vitin 2013



Grafiku 2- Nafta e prodhuar në vitin 2014



2 - Informacioni për rezervat dhe prodhimin kumulativ është raportuar nga Albpetrol. Të dhëna të përmbledhura janë paraqitur në këtë adresë: <http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/>



## Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi në sektorin minerar

Shqipëria ka një histori të gjatë në sektorin minerar me depozita të mëdha të mineraleve të kromit, nikelit, bakrit dhe gurit gëlqeror.


Sipas Ligjit Minerar, konçensionit për shfrytëzimin minerar mund të jepen për 25 vjet, dhe janë subjekt rinovimi deri në 10 vite shtesë.

Si një vend tradicional minerar, Shqipëria ka një numër në rritje të shoqërive të vogla dhe të mesme në sektorin minerar dhe të karrierës, si dhe numëron vetëm disa shoqëri të mëdha industriale. Në Nentor 2015, AKBN raportoi 600 licenca minerare, nga të cilat 112 licenca prodhonin krom në minierat e Bulqizës.

### Minerali i kromit

Rezervat e rikuperueshme të kromit (me cilësi mesatare 30.8% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>) vlerësohen rreth 10 milion ton<sup>3</sup>, dhe janë përqëndruar kryesisht në rajonin e Bulqizës, Kukësit, Hasit, Matit dhe Pogradecit..

Figura 2 - Harta e depozitave të kromit



© Albchrome Sh.p.k.

### Minerali i bakrit

Rezervat gjeologjike të mineralit të bakrit (përfshirë Cu 1.3-2.65%, zink, ar dhe argjend) vlerësohen rreth 50 milion ton . Gjithësesi, rezervat e rikuperueshme vlerësohen të jenë jo më shumë se 27 milion ton. Depozitat e bakrit ndodhen në gjashtë rajone: Korçë, Mirditë, Pukë, Shkodër, Kukës dhe Has.

### Minerali i hekur-nikelit dhe nikel-silikate

Rezervat e nikelit në Shqipëri (Ni 0.85-1.15%) gjenden kryesisht në afërsi të Pogradecit, Librazhdit, Bilishtit, Kukësit dhe Peshkopisë dhe vlerësohen të jenë rreth 300 milion ton.

### Minerale jo-metallore

Studimet gjeologjike në Shqipëri deri në vitin 1995 tregojnë për 32 lloje të ndryshme të shkëmbinjve dhe mineraleve jometalorë industriale duke përfshirë: shkëmbijtë gëlqeror, shkëmbijtë ranor, dolomit, gurë dekorative karbonatikë, argjilë, granitit, gips etj. Këto minerale mund të nxirren përgjatë gjithë vendit tonë. Ato përbëjnë lëndën e parë kryesore për industrinë e ndërtimit në Shqipëri.

Depozitat e bitumit dhe asfaltit ndodhen në afërsi të Selenicës në luginës së lumit Vjosë. Shqipëria gjithashtu zotëron depozita të mëdha të kripës, në afërsi të Kavajës dhe Vlorës.

Figura 3 - Harta e depozitave të bakrit



3, 4, 5 - Burimi VKM nr.479, datë 29 qershor 2011 "Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë".

# Industria nxjerrëse në Shqipëri

Sipas AKBN, prodhimi mineralar ishte përrreth 140.9 milion USD në vitin 2013 dhe 175.5 milion USD në vitin 2014. Prodhimi i kromit përbën përkatësisht rreth 72% dhe 76% të prodhimit mineralar vendas në vitin 2013 dhe vitin 2014

## Prodhimi i kromit

Sipas AKBN liçensat aktive prodhuan rreth 526,230 ton krom në vitin 2013 dhe 712,374 ton krom në vitin 2014. Prodhimi i kromit nga minierat e Bulqizës zinte një peshë të rëndësishme në prodhimin total me rreth:

- 45% në vitin 2013, dhe
- 57% në vitin 2014.


Albchrome (ACR – më parë Albanian Chrome), i cili kryen aktivitetin në minierat e Bulqizës, ishte prodhuesi më i madh i kromit në Shqipëri me rreth 12% të prodhimit total të kromit në vitin 2013 dhe 10% në vitin 2014. Në të njëjtat vite shoqëria punësoi rreth 600 punonjës, duke përfaqësuar mbi 20% të forcës punëtore në sektor. Krahas Albchrome, shumë shoqëri të mesme dhe të vogla (më shumë se 280 liçensa) kanë nxjerrë krom nga Bulqizë, Tropojë, Has, Kukës, Mat etj.

## Prodhimi i bakrit

Beralb ishte e vetmja shoqëri industriale angazhuar në nxjerrjen e bakrit në vitin 2013 dhe 2014, me rreth 100% të vlerës së prodhimit të bakrit në të dy vitet. Beralb zotëron liçensa prodhimi për minierat e Munellës, Lak Roshit, Karmës dhe Fushë Arrës, të gjitha të vendosura në krahinën e Pukës.

Grafiku më poshtë paraqet prodhimin sipas mineraleve kryesore në USD në vitin 2013 dhe 2014:

Grafiku 3 – Prodhimi mineralar në USD në vitin 2013 dhe 2014



## Prodhimi i përbërjeve të nikelit

Në vitin 2013, nikeli u nxorr kryesisht në formën e hekur-nikelit dhe silikatit të nikelit, në rajonet e Hasit 44%, Librazhdit 22% dhe Pogradecit 29%. Në vitin 2014, 63% e prodhimit u nxorr në Librazhd, ndërkohë që në Kukës dhe Pogradec prodhimi zinte përkatësisht rreth 12% të prodhimit total të nikelit. Sipas AKBN, rajoni i Has-it nuk ka raportuar prodhim të nikelit në vitin 2014.

Prodhimi në të dy vitet, u gjenerua nga shoqëri minerare të vogla dhe të mesme, si dhe disa të liçensuar që mblidhnin nikelin nga shoqëritë e vogla dhe të mesme

## Prodhimi i gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera

Një numër i madh shoqëri të vogla vepronin në nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe materialeve të tjera të ndërtimit në vend. Antea Cement, me veprimtari në Krujë, ishte prodhuesi më i madh në vitin 2013 dhe 2014 me rreth 24% dhe 20% të prodhimit total në keto vite.

# Sektori i hidro-energjisë në Shqipëri

## Potenciali Hidro-Energjistik në Shqipëri

Sistemi energjetik shqiptar praktikisht mbështetet vetëm në hidrocentralet (HEC) dhe për këtë arsye ai është krejtësisht i varur nga kushtet hidrologjike. Sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë <sup>6</sup>, prodhimi i përgjithshëm vjetor i mundshëm nga hidrocentralet në Shqipëri është vlerësuar në 10,000 GWh. Kjo mund të përftohet nga një kapacitet i instaluar prej 3,000 MW. Bazuar në këto të dhëna, në fund të vitit 2014 mundësitë e shfrytëzuara deri tani përfaqësojnë 58% të potencialit të hidro-energjisë me kapacitet total të instaluar prej 1,725 MW.

Ligji dhe kuadri rregullativ për koncesionet përcakton kriteret dhe procedurat për vlerësimin e mundësive dhe dhënien e koncesioneve në sektorin e hidro-energjisë për një periudhë jo më shumë se 35 vjet. Të gjitha koncesionet hidro-energjetike miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministria përgjegjëse për energjinë është autoriteti kontraktues për të gjitha koncesionet e dhëna në sektorin e hidro-energjisë.

Drini, që kalon tej për tej vendin në veri, është lumi më i madh në Shqipëri. Tre hidrocentralet më të mëdha në vend: Fierza, Komani dhe Vau i Dejës u ndërtuan në formë kaskade mbi lumin Drin nga viti 1971 deri në vitin 1985 me një kapacitet të instaluar prej 1,350 MW.

Vjosa dhe Devolli janë gjithashtu lumenj të medhenj në vend. Studimet në këto lumenj tregojnë për mundësitë e zhvillimit të disa hidrocentraleve të vegjël dhe të mesëm.

Figura 2 – Potenciali hidro-energjetik në Shqipëri



6 - Strategjia Kombëtare e Energjisë, e miratuar në korrik të vitit 2003 mund të gjendet në faqen e internetit të AKBN: [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

# Sektori i hidro-energjisë në Shqipëri

Prodhimi hidro-energjetik në Shqipëri dominohet nga sektori publik. Në fund të vitit 2014, Shteti Shqiptar zotëronte dhe administronte Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

KESH është prodhuesi më i madh në vend. Me një kapacitet të instaluar prej 1,448 MW ose 80% të fuqisë totale të instaluar në vend, ndërtuar në kaskadën e lumit Drin në veri, KESH gjeneroi rreth 87% të prodhimit të energjisë në vitin 2013. Kjo peshë ra në 72% në vitin 2014, për shkak të rritjes së aktivitetit të HEC-eve private dhe HEC-ve me koncesion në këtë sektor.



Panvarsisht nga potenciali hidro-energjetik, në 15 vitet e fundit, Shqipëria ka qenë kryesisht një importues neto i energjisë elektrike për të kompensuar bilancin e vazhdueshëm negativ të energjisë.

Ky bilanci negativ i energjisë vjen kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të humbjeve në rrjet. Bazuar në të dhënat e raportuara nga INSTAT prodhimi vjetor mesatar për periudhën nga viti 2000 deri në vitin e 2014 përbën rreth 76%<sup>7</sup> të energjisë vjetor transmetuar në rrjet, duke

përfshirë humbjet.

Nëse humbjet teknike dhe financiare në rrjet do të eliminohen plotësisht, siç tregohet në Grafikon 5, bilanci i energjisë do të përmirësohej në mënyrë të ndjeshme dhe do të arrinte një prodhim mesatar në masën 122%<sup>8</sup> të totalit të nevojave për energji elektrike në vend.

Grafiku 5 tregon një bilanc pozitiv të energjisë gjatë gjithë periudhës, me përjashtim të viteve 2002, 2007, 2008 dhe 2011, kur prodhimi nuk arriti të mbulonte nevojat e brendshme për energji. Kjo vjen si rrjedhojë e kushteve jo të favorshme meteorologjike si dhe mosshfrytëzimit të potencialeve energjetike të vendit.



7, 8 - Përllogaritur si mesatare e thjeshtë vjetore e raportit të prodhim – përdorim përgjatë viteve 2000 - 2013. Burimi i të dhënave nga "Bilanci energjisë elektrike, 2000 -2013" - www.instat.gov.al.

ERE raportoi një prodhim vendas hidro-energjitik prej 6,956 GWh në vitin 2013 dhe 4,726 GWh në vitin 2014. Megjithatë, kontributi i sektorit përlogaritet jo më pak se 0.2% të të ardhurave totale në Buxhetin e Shtetit në vitin 2013 dhe 0.1% në vitin 2014.

Shteti shqiptar e subvencionon sektorin e energjisë elektrike nëpërmjet rregullimit të çmimit për shitjen e energjisë së prodhuar, trasmetimin dhe shpërndarjen e saj. Si rrjedhojë, KESH e shet prodhimin e tij me çmim të rregulluar prej 1 Lek për KWh (ekuivalente me 0.01 USD për KWh). Për shkak se KESH ka një pozicion dominues në sektorin e prodhimit hidro-energjitik, shitjet nga ky sektori nuk i kalojnë 11 miliard Lek (ekuivalente me 106 milionë USD) në vitin 2013 dhe në 9.6 miliard Lek (ekuivalente me 91 milionë USD) në vitin 2014. Nëse prodhimi vendas do të vlerësohej me çmimet mesatare zbatuar në eksportet e energjisë, vlera e prodhimit vendas do të ishte rreth 25.5 miliard Lek (ekuivalente me 243 milionë USD) në vitin 2013 dhe 24.1 miliard Lek (ekuivalente me 229 milionë USD) në vitin 2014.

Në vitin 2013, humbjet në sistemin e shpërndarjes për shkak të kushteve të dobta teknike dhe lidhjeve informale në sistem ishin rreth 45% e energjisë së transmetuar. Në vitin 2014, humbjet ranë në 37.81% të energjisë së transmetuar<sup>9</sup> si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Qeverisë Shqiptare dhe OSHEE. Kontributi i munguar i humbjeve të energjisë matur

me çmimet mesatare të eksportit vlerësohet të jetë rreth 22.3 miliard Lek në vitin 2013 (ekuivalente me 212 milionë USD) dhe 19.9 miliard Lek në vitin 2014 (ekuivalente me 190 milionë USD).

Të dhënat e raportuara nga AKBN tregojnë se një numër i madh HEC-sh dhënë me kocension nuk kanë filluar ende ndërtimin ose janë ende në ndërtim e sipër në datën e këtij raporti, duke shfaqur vonesa me dy ose më shumë vite. Më konkretisht, nga 502 HEC-e dhënë me kocension, 308 HEC-e me fuqi të instaluar prej 1,152 MW dhe energji të parashikuar prej 5,359 GWh nuk kanë filluar ende ndërtimin. Ndërsa 84 HEC-e janë në fazën e ndërtimit. Nëse të gjitha HEC-et do të kishin përfunduar ndërtimin brenda dy vjetëve nga data e kocensionit dhe do të prodhonin energjinë e parashikuar në kontratën e kocensionit, tarifa e kocensionit do të ishte rreth 1.78 miliard Lek në vitin 2013 dhe rreth 1.9 miliard Lek në vitin 2014. Këto vlera janë mbi 10 herë më shumë se të ardhurat nga tarifa e kocensionit e mbledhur në të dy vitet.

9 - Energjia e transmetuar përfshin njëkohësisht konsumin e brendshëm të energjisë dhe humbjet.



# Kontributi në ekonominë shqiptare

Bazuar në rezultatet paraprake të publikuara nga INSTAT, sektori i energjisë dhe burimeve përbënte 7% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në vitin 2013 dhe 2014. Sektori i naftës dhe ai mineralar së bashku përbënin 5% të PBB-së, ndërkohë që sektori i energjisë elektrike kontriboi me rreth 2% të PBB-së në të dy vitet.


**Nafta e papërpunuar** përbënte burimin kryesor të energjisë së prodhuar në Shqipëri duke përfaqësuar 67.7% të burimeve parësore të energjisë së prodhuar në vitin 2014 (2013: 59.1%) ndjekur nga sektori i energjisë elektrike me rreth 20% të burimeve parësore të energjisë së prodhuar në vitin 2014 (2013: 29.3%).

Statistikat e Qeverisë nuk mundësojnë shifra të sakta të të ardhurave totale që Qeveria gjeneron nga sektori nxjerrës. Megjithatë, po të kemi parasysh të ardhurat e gjeneruara nga flukset kryesore të të ardhurave (renta minerare, tatimi mbi fitimin, ndarja e prodhimit të naftës, bonuset e nënshkrimit, dhe pagesat e tjera të industrisë), industria nxjerrëse dhe sektori hidro-energjitik kanë kontribuar **jo më pak se 12.9 miliard Lek ose 3.9 % e të ardhurave totale në Buxhetin e Shtetit në vitin 2013. Në vitin 2014, sektori nxjerrës dhe sektori i hidro-energjisë ka kontribuar jo më pak se 12.7 miliard Lek ose 3.5% të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit** (referoju tabelës 2).

Kontributi i pagesave nga industria nxjerrëse dhe sektori i hidroenergjisë ishte 3.5% e totalit të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit në vitin 2014 (2013: 3.9%)

Kontributi i industrisë nxjerrëse në punësim mbetet modest. Sipas AKBN, shoqëritë e licensuara në nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve e tjera punësojnë së bashku më pak se 1% të totalit të të punësuarve në vend.

**Grafiku 4 – Kontributi i energjisë dhe burimeve në PBB (me cmimet aktuale)**



Burimi: INSTAT- Llogarite Kombetare Vjetore (metoda e prodhimit)

Tabela 2 – Të ardhurat e Shtetit nga sektori nxjerrës dhe hidro-energji

Në milion Lek

Llojet e pagesave (*)	2013						2014					
	Albpetrol	AKBN	ERE	KESH	Buxheti i Shtetit	Totali	Albpetrol	AKBN	ERE	KESH	Buxheti i Shtetit	Totali
Ndarja e prodhimit të naftës	4,968	-	-	-	-	4,968	4,354	-	-	-	-	4,354
Bonuset	11	47	-	-	-	58	12	23	-	-	-	35
Tarifa kocensionare	-	-	-	133	-	133	-	-	-	190	-	190
Pagesat rregullatore	-	-	23	-	-	23	-	-	72	-	-	72
Të tjera	-	-	-	-	-	-	-	633	-	-	-	633
Renta minerare	-	-	-	-	10,037	10,037	-	-	-	-	9,730	9,730
Tatimi mbi fitimin	-	-	-	-	2,885	2,885	-	-	-	-	2,224	2,224
Dividendët	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	757	757
	4,979	47	23	133	12,922	18,104	4,366	656	72	190	12,711	17,995
Nafta dhe gazi	4,979	47	-	-	9,970	14,996	4,979	656	-	-	9,904	15,539
Minerar	-	-	-	-	2,433	2,433	-	-	-	-	2,554	2,554
Hidro-energji	-	-	23	133	520	676	-	-	72	190	253	515

(\*) Pagesat listuar më sipër përfaqësojnë pagesat më të rëndësishme kryer nga shoqëritë e licensuara Buxheti të Shtetit, AKBN-së, ERE-s, KESH-it dhe shoqërisë Albpetrol, të përzgjedhura për rakordim në këtë raport. Kjo listë nuk përmbledh të gjitha pagesat e zbatueshme. Sistemet e informacionit të Qeverisë nuk e mundësojnë paraqitjen e totalit të të ardhurave arkëtuar nga tre sektorët. Duke përfshirë rentën minerare, e cila është paraqitur e plotë nga agjentët mbledhës, respektivisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Doganore Shqiptare, pagesat e tjera përmbledhin shumat deri në nivelin e raportuar nga të licensuarit dhe institucionet publike mbledhëse për qëllime rakordimi në këtë raport. Për këtë arsye, me përjashtim të rentës minerare, shumat e treguara më sipër nuk japin totalin e të ardhurave të qeverisë në sektorin e naftës, minerar, dhe hidro-energjisë.

Renta minerare përbën fluksin kryesor të të ardhurave nga sektori nxjerrës i naftës, gazit dhe minerar në Buxhetin e Shtetit. Renta e mbledhur në vitin 2014 ishte 3% më pak se në vitin 2013. Renta minerare pësoi ulje, pavarësisht rritjes së prodhimit të naftës dhe atij minerar. Ky trend është pasojë e rënies së çmimeve të naftës dhe mineraleve në tregun ndërkombëtar. Ndarja e prodhimit të naftës përbën grupin e dytë më të madh të të ardhurave të mbledhura nga sektori i naftës. Shoqëritë private të naftës paguan në natyrë gjithë sasinë e prodhimit të naftës prej 75,825 ton në vitin 2013 dhe 94,304 ton në vitin 2014. Vlerat e treguara më sipër për të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës janë vlerësuar me çmimin mesatar të shitjeve vjetore zbatuar nga Albpetrol prej 441 \$/ton në vitin 2013 dhe 396 \$/ton në vitin 2014. Shumat në dollar janë përkthyer në Lek me normën mesatare vjetore sipas Bankës së Shqipërisë, respektivisht 1 dollar i barabartë me 105,7 Lek në vitin 2013 dhe 1 dollar i barabartë me 105.5 Lek në vitin 2014.

Në vitin 2013 Buxheti i Shtetit arkëtoi të ardhura prej 15,439 miliard Lek nga privatizimi i hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit dhe Bistricës 1 dhe 2, të cilat vepronin nën administrimin e KESH deri në mes të vitit 2013. Për shkak të natyrës që ka kjo e ardhur nuk është përfshirë në tabelën më sipër. Nëse kjo shumë do të përfshihej në të ardhurat e përmbledhura më sipër, kontributi në Buxhetin e Shtetit do të rritej nga 3.9% deri në 8.7%.

# Kontributi në ekonominë shqiptare

Lloji kryesor i të ardhurave që lidhen drejtpërdrejtë me sektorin nxjerrës paraqitet si më poshtë:

Renta minerare paguhet për shfrytëzimin e burimeve natyrore, në bazë të ligjit “Për taksat kombëtare” nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar. Renta minerare për eksportet mblidhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe renta minerare nga shitjet brenda vendit mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sipas ligjit për taksat kombëtare, renta minerare nga shitja e naftës dhe gazit përlllogaritet në 10% e vlerës së tatueshme, ndërsa për mineralet e tjera renta varion nga 4% në 7%.

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi fitimin e tatueshëm të shoqërisë. Deri në dhjetor 2013, tatimi mbi fitimin në Shqipëri përlllogaritet me 10% e fitimit të tatueshëm në përputhje me “Ligjin për tatimin mbi të ardhurat” Nr. 8438, datë 28 Dhjetor 1998, ndryshuar. Më 1 Janar 2014, norma e aplikushme e tatimit mbi fitimin u rrit në 15%. [Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin minerar.](#)

Tatimi mbi fitimin në sektorin hidrokarbur përlllogaritet në 50% mbi fitimin e tatueshëm sipas Dekreti nr. 782 “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve”, datë 22 dhjetor 1994 (“Ligji për tatimin e naftës”). Sipas këtij ligji, në përlllogaritjen e fitimit të tatueshëm merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet operative dhe kapitale të akumuluar siç përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbura.

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit janë terma pagese tipike të marrëveshjeve hidrokarbure. Ato përcaktohen (sipas negociatave të marrëveshjes) në momentin e dhënien së lejes të kërkimit ose prodhimit të naftës dhe gazit sipas termave dhe kushteve specifike të kontratës. Bonuset e nënshkrimit mblidhen nga Albpetrol (për nënshkrimin e liçensave të prodhimit) dhe AKBN (për nënshkrimin e lejeve të kërkimit).

Ndarja e prodhimit të naftës - Albpetroli zotëron pjesë nga nafta e prodhuar nga liçensë-marrëveshjet nën administrimin e tij. Si rrjedhojë, Albpetroli ka të drejtë të përfitojë pjesë nga ndarja e prodhimit për prodhimin ekzistues dhe prodhimin e nxjerrë nga shoqëria e liçensuar, siç përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbure. Ndarja nga prodhimi mund të paguhet në para ose në natyrë. Në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure, shoqëritë duhet t’i kalojnë Albpetrolit prodhimin ekzistues në masën 65 deri në 75% dhe pjesë nga prodhimi vetjak në masën 1 deri në 5%. Albpetroli është gjithashtu subjekt i tatimit dhe taksave të aplikueshme për shoqëritë tregtare të naftës si tatimi mbi fitimin, renta minerare, TVSH etj. Shteti, në cilësinë e aksioner, ka të drejtë të përfitojë dividendët dhe të ardhurat nga privatizimi i Albpetrol.

Tarifa kocensionare i paguhet Autoritetit Kontraktues në përqindje mbi vlerën e prodhimit vjetor të energjisë elektrike dhe çdo përfitimi tjetër që rrjedh nga marrëveshja. Kjo përqindje është pjesë konfidenciale e marrëveshjes dhe ndryshon në kocensione të ndryshme. Tarifa përlllogaritet në përqindje mbi çdo faturë mujore të energjisë së shitur tek KESH dhe mblidhet nga KESH për llogari të Autoritetit Kontraktues, në përputhje me Urdhërin Nr. 4 datë 9 janar 2012 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, përgjegjëse për sektorin e energjisë në atë kohë.

## Transfertat lokale

Renta minerare e arkëtuar nga shitja e naftës, gazit dhe mineraleve është regjistruar në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për Taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 Korrik 2008, i ndryshuar, një pjesë e taksës së rentës minerare do të transferohet tek çdo njësi e qeverisjes vendore ("NJQV"), në përpjesëtim me kontributin e tyre në prodhimin dhe shitjen e mineraleve.

Deri në nëntor të vitit 2014, Ligji për taksat kombëtare ka kërkuar që 25% e taksës së rentës minerare t'i transferohej çdo njësie të qeverisjes vendore ("NJQV"), në përpjesëtim me kontributin e tyre dhe në kuadër të kushteve të ligjit të buxhetit vjetor.

Më 27 Nëntor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet në Ligjin për taksat kombëtare. Sipas ndryshimeve të propozuara, NJQV-të do të kenë të drejtë të marrin 5% të rentës minerare të gjeneruara nga Shoqëritë që operojnë në zonën e tyre pa marrë parasysh ndonjë transferim të parashikuar në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor.

Ministria e Financave njoftoi se pagesat lokale të rentës minerare arritën në 101 milionë Lek në vitin 2013 dhe 120 milion Lek në vitin 2014. Këto transfertat janë shpërndarë vetëm tek rajonet prodhuese të naftës, ku 35% e totalit të rentës minerare të shpërndarë shkoi për Bashkinë e Patosit në të dy vitet

Transfertat e rentës minerare tek NJQV-të në prodhimin e naftës përbëjnë rreth 1.2% të rentës minerare të gjeneruar nga sektori i naftës në vitin 2013. Ky raport u rrit në 1.5% në vitin 2014. Ministria e Financave raportoi se nuk ka transfertat të rentës minerare të kryera tek vendet prodhuese në sektorin minerar


## Eksportet nga industria nxjerrëse

Eksportet nga sektori nxjerrës janë rritur ndjeshëm me mbi 100% në katër vitet e fundit.

Në vitin 2013 eksportet nga sektori nxjerrës arritën në 96.7 miliard Lek ose 39% të totalit të eksporteve. Në vitin 2014, eksportet ranë në 82.2 miliard Lek ose 32% të totalit të eksporteve.

Siç tregohet në grafikun 7, kjo rënie i atribuohet rënies së eksporteve të naftës së papërpunuar të cilat zinin peshën më të lartë të eksporteve nga sektori nxjerrës në katër vitet e fundit me rreth 64% deri në 75%.

Nafta e papërpunuar u eksportua kryesisht në Itali, Spanjë dhe Maltë. Ndërsa Kina ishte importuesi kryesor i mineralve të kromit dhe bakrit prodhuar në vend.



Burimi – Administrata Doganore Shqiptare <sup>11</sup>

11 - Administrata Doganore Shqiptare e raportoi zyrtarisht këtë informacion për përpilimin e këtij raporti.





# Rakordimi i të ardhurave dhe pagesave

## Përzgjedhja e shoqërive raportuese për vitet 2013 dhe 2014

Të gjitha shoqëritë që operonin një liçensë në kërkim-zbulim për naftën, gazin dhe mineralet dhe një liçensë prodhimi në naftë dhe gaz, u përzgjedhën të raportojnë pagesat sipas Standartit EITI. Kështu, fluksi i parasë së rakorduar për sektorin e naftës dhe gazit përfaqëson 100% të fluksit të parasë kontribuar në total nga ky sektor për llojet të ardhurave përfshirë në këtë rakordim.

Për shkak të numrit të madh të shoqërive prodhuese me shkallë të vogël aktiviteti, në sektorin mineral dhe atë të hidro-energjisë u zbatuan kritere të caktuara materialiteti ndaj xhiros dhe prodhimit vjetor me qëllim përzgjedhjen e prodhuesve më të mëdhenj. Përzgjedhja rezultoi në:

- 81 shoqëri minerare në vitin 2013, (85% të vlerës së prodhimit)
- 99 shoqëri minerare në vitin 2014, (87% të vlerës së prodhimit)

Në sektorin e hidro-energjisë, MSG përzgjedhi 10 prodhuesit më të mëdhenj duke përfshirë KESH (90% të prodhimit hidro-energjetik) dhe pesë investuesit më të mëdhenj në HEC-e ende në fazë ndërtimi.

Krahasimi i pagesave me të ardhurat rezultoi me disa mospërputhje. Pjesa më e madhe e mospërputhjeve u shpjegua nëpërmjet punës së rakordimit. Mospërputhjet e shpjeguara rezultuan kryesisht për shkak të shumave të paraportuara fillimisht ose gabimeve në raportim.

Deri në datën e këtij Raporti flukset e parasë u rakorduan në 99% e flukseve të raportuara nga të liçensuarit dhe Shteti ose të liçensuarit dhe Albpétrol në të dy vitet.

Tabela 3 Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Buxhetit të Shtetit në vitet 2013 dhe 2014

Pagesat e agreguara	Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2013			Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2014		
	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja
Sektori i naftës dhe gazit	12,307	12,339	(32)	14,396	14,417	(21)
Sektori mineral	1,325	1,391	(66)	1,493	1,495	(3)
Sektori i hidro-energjisë	19,324	19,275	49	1,486	1,486	(0)
Albpétrol	2,543	2,554	(11)	3,556	3,595	(38)
<b>Totali</b>	<b>35,499</b>	<b>35,559</b>	<b>(60)</b>	<b>20,930</b>	<b>20,993</b>	<b>(62)</b>

Tabela 4 Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Albpétrol për ndarjen e prodhimit të naftës dhe bonuset sipas marrëveshje në vitet 2013 dhe 2014

Pagesat e agreguara	Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2013			Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2014		
	Të liçensuarit	Albpétrol	Mospërputhja	Të liçensuarit	Albpétrol	Mospërputhja
Ndarja e prodhimit të naftës	3,530	3,530	-	3,934	3,942	(8)
Bonuset - Albpétrol	10,695	10,695	-	17	12	(5)
<b>Totali</b>	<b>3,540</b>	<b>3,540</b>	<b>-</b>	<b>3,952</b>	<b>3,954</b>	<b>(13)</b>

Deloitte kryen shërbime këshillimi për auditin, taksat dhe financat për klientë publikë dhe privatë që kapin një shtrirje të gjerë industriale. Me një rrjet që lidh globalisht anëtarët e firmave në 150 vende, Deloitte sjell aftësi të një rangu botëror dhe ekspertizë të thelluar lokale që të ndihmojë klientët e vet t'ia dalin kudo ku veprojnë. 210 000 punonjësit profesionistë të Deloitte janë të përkushtuar për t'u shndërruar në standard të ekselencës.

Punonjësit profesionistë të Deloitte i përbashkon kultura e bashkëpunimit që ushqen integritetin - vlerë e jashtëzakonshme për tregun dhe klientët, përkushtimin ndaj njëri-tjetrit, si dhe forcën si pasojë e diversitetit. Ata shijojnë frytet e një mësimi të vazhdueshëm, përvojave sfiduese dhe mundësive të shumta për të bërë karrierë. Punonjësit profesionistë të Deloitte janë të përkushtuar në forcimin e përgjegjësisë së korporatës, ndërtimin e besimit publik, si dhe në krijimin e një ndikimi pozitiv në komunitetet e tyre.

Deloitte i referohet një ose më shumë se një Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private në Mbretërinë e Bashkuar me garanci të kufizuar, si dhe rrjetit të saj të firmave anëtare, secila prej të cilave është një entitet ligjorisht i ndarë dhe i pavarur. Ju lutemi, lexoni në [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) për një përshkrim më të hollësishëm të strukturës ligjore të Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare.